

Emri i Lëndës : Analizë Teksti I							
Kodi	Tipi	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
ELL 211	B	Vjeshtë	4.00	0.00	0.00	4.00	5.00
Lektori		Albana Cekrezi, PhD					
Asistenti							
Gjuha e kursit		Anglisht					
Niveli i lëndës		Bachelor					
Përshkrimi		Kursi i analizës së tekstit inkurajon aftësitë e avancuara të leximit dhe analizës të llojeve të ndryshme të teksteve: tregim, poezi, materiale akademike, artikuj etj. Lënda fokusohet në analizën e tekstit letrar, pasi u prezanton studentëve qëllimin e analizës së tekstit dhe mënyrat e kryerjes së tij. Një rëndësi e veçantë i kushtohet tregimeve të shkurtra.					
Objektivat		Ky kurs ka për qëllim të orientojë studentët të kuptojnë, analizojnë llojet e teksteve, strukturën e tyre, qëllimin, stilin dhe teknikat që janë përdorur kryesisht në tregime të shkurtra. Gjithashtu, synohet përmirësimi i aftësive analitike, të kuptuarit si dhe rritja e perceptimit të studentit në identifikimin e tematikave, simboleve dhe lidhjes me tekste të tjera.					
Konceptet Kryesore		Analize teksti, llojet e analizës, analiza letrare, tregime të shkurtra, simbole, tema, imazhe, parathenie, ironi, etj.					
Programi i Lëndës							
Java	Tema						
1	Përse të studiojmë analizën e tekstit? Gjuha është një burim i madh të dhënash mbi fenomene komplekse. Tekstet mund të jenë gjurmë të një njësie më të madhe ose më interesante për studim. Analiza e tekstit të strukturuar varion në disa lloje. Analiza e përmbajtjes analizon tekste të vogla dhe të izoluar si dhe prodhon kategori, frekuenca etj. Analiza semantike studion lidhjet midis njësive, lidhje gramatika dhe prodhon harta kuptimore etj. Analiza narrative i referohet strukturave më të mëdha të tekstit si elementët, ngjarjet etj. Analiza e diskursit përfshin disa lloje tekstesh dhe prodhon ideologji, mite institucionale apo dhe kontradikta politike.						
2	Studentët eksplorojnë teoritë dhe kritikën letrare, duke përfshirë feminizmin dhe psikoanalizën. Kursi do të përfshijë strukturën dhe teknikën narrative, duke shqyrtuar elemente si ngjarja, karakteri dhe tema. Analiza retorike mund t'i ndihmojë studentët të identifikojnë strategji si etosi, pathos dhe logos, ndërsa analiza kontekstuale thekson rëndësinë e konteksteve historike dhe kulturore. Studimet mbi zhanret dhe ndërtekstualiteti do të forcojnë kuptimin e tyre për mënyrën se si zhanre dhe tekste të ndryshme ndikojnë njëra-tjetrën. Së fundi, prezantimi i mjeteve të analizës së teksteve dixhitale do t'u lejojë studentëve të angazhohen me tekstet duke përdorur metoda dhe qasje moderne.						
3	Rënia e shtëpisë Usher. Pjesa e parë e analizës prezanton lexuesin me personazhet kryesore, vendin dhe imazhin. Rrëfyesi i ngjarjes qëndron anonim përgjatë tregimit. Por, ne kuptojmë që ai është një mik fëmijërie, Roderick Usher dhe gjendet aty për një vizitë. Historia tregohet nga perspektiva e kufizuar e vetës së parë, që nënkupton tregimi do të jetë i limituar nga eksperiencia e tij. Gjithashtu, gjate kësaj pjese do të analizohen fjalë kyce që ndihmojnë në formimin e temave dhe imazhit.						
4	The Fall of the House of Usher 2-Personazhi kryesor i tregimit të shkurtër analizohen nëpërmjet fjalëve që thotë dhe veprimeve që bëjnë. Roderick Usher cilësohet si një karakter misterioz. Shtëpia e tij analizohet në detaje. Ajo cilësohet dhe si një karakter më vete me dualitetin që shprehet në strukturën fizike dhe linjën familjare.						

5	The Fall of the House of Usher 3-Kjo pjesë është pjesa përfundimtare e analizës. Studentëve u kërkohet të analizojnë në mënyrë kritike përtej fjalëve dhe shprehjeve në tekst. Temat kryesore të tregimit si: vetmia, izolimi, frika analizohen në detaje. Gjithashtu përfshihet dhe analiza e karaktereve.
6	Annabel Lee është një poezi me rimë. Në të përshkruhet dashuria midis dy personazheve, Annabel Lee dhe narrator i cili mendohet të jetë vetë autori. Mendohet se poezia i referohet dashurisë që ai kishte për të afërmen e tij Virgia. Poezia përmban një atmosferë të mbinatyrshme me referime të ënjgjëve dhe dajve të cilët mundohet të ndajnë dy të dashëruarit.
7	“Korbi”, I publikuar fillimisht në 1845, e bëri E.A. Poe të famshëm dhe mbetet vepra e tij më e arrirë. Atmosfera vetmitare, mesazhi tmerrues i korbit dhe bukuria gjithëpërfshirëse rezultojnë në një poemë të paharrueshme. “Korbi” është një tregim klasik mbi humbjen dhe vajtimin. Protagonisti i paidentifikuar, një shkollor, ulet në studion e tij në një mbrëmje nate dimri. Vajtimi i tij për të dashurën e vdekur shfaqet në formën e një korbi.
8	Provim Gjysmë-final
9	“Korbi” 2- Poe shpjegon në esenë e tij se burimi i shkrimit të Korbit nuk ka qenë një inspirim i rastësishëm. Përkundrazi, ai e përgatiti “Korbi”-n përmes një sërë vendimesh të përlogaritura. Pasi vendosi se gjatësia e përsorur e saj do ishin 100 rreshta dhe bukuria si efekti kryesor, Poe zgjodhi melankolinë si “manifestimin më të lartë të bukurisë” dhe “më të arsyeshmen e toneve poetike”. Sipas tij, historia e vdekjes të së bukurës Lenorë i erdhi në mendje pas refrenit të korbit “Kurrë më”.-një refren i zgjedhur për cilësitë e tij të tingullit. Historia e Lenorës shërben si zgjidhje pasi melankolia përkon me refrenin e korbit.
10	The Cask of Amontillado” (1846) (Fucia e Amontillados), ashtu si në shumë prej tregimeve të Poe-s, historia mbështet në mungesën e provave që shoqërojnë pretendimet e Montresor ndaj Fortunatos dhe “mijëra lëndime” dhe “ofendim”. Hakmarrja dhe “ofendimi”. Hakmarrja dhe vrasja sekrete janë si një mënyrë për të shmangur ligjin dhe dënimin. Ligji nuk gjendet gjëkund në radarin e Montresorit dhe tmerrri në tregim qëndron në dënimin pa provë.
11	The Black Cat (Maci i zi)- Çështjet kyçe në "Maca e Zezë" përfshijnë fajin dhe ndërgjegjen, ndërsa narratori përballlet me pasojat e veprimeve të tij të dhunshme. Alkoholi shërben si një katalizator për rënien e tij në çmenduri dhe degradim moral. Historia trajton temat e dhunës dhe abuzimit, veçanërisht në keqtrajtimin e kafshëve. Elementët mbi natyrën e mbinatyrshme kontrastojnë me shpjegimet racionale, duke ngritur pyetje mbi realitetin. Së fundi, humbja e identitetit nga narratori pasqyron pasojat vetë-shkatërruese të zgjedhjeve të tij.
12	"The Tell-Tale Heart" është një tregim i shkurtër i Poe, rrëfyer nga një narrator i paidentifikuar i cili përpjeket të bindë lexuesin se nuk është i marrë. Ndërkohë, rrëfen një vrasje që ka bërë. Viktima është një i moshuar. Vrasja është e mirëplanifikuar, dhe vrasësi fsheh trupin duke e copëtuar dhe fshehur në dërrasat e dyshemesë. Në përfundim, faji i rrëfyesit paraqitet në formën e një zëri, me shumë mundësi të një halucinacioni-atë të zemrës së të moshuarit që rreh nën dërrasat e dyshemesë.
13	Në "Equally Unequal" studentët mund të eksplorojnë temën e pabarazisë sistematike dhe si ajo shfaqet në struktura të ndryshme shoqërore. Ata duhet të analizojnë ndërthurjen e racës, klasës dhe gjinisë, dhe si këta faktorë ndikojnë në përvojat e individëve. Narativa sfidon nocionin e barazisë duke theksuar pabarazitë që vazhdojnë të ekzistojnë pavarësisht kuadrove ligjore formale. Studentët mund të shqyrtojnë gjithashtu përdorimin e statistikave dhe anekdotave personale nga autori për të forcuar argumentet e tij. Së fundi, teksti fton një diskutim kritik mbi zgjidhjet e mundshme dhe rëndësinë e veprimit kolektiv në adresimin e pabarazisë.
14	Prezantime
15	Prezantime
16	Provim Final

Parakushtet	Studenti duhet të frekuentojë lëndën në masën minimale prej 75%.
Literatura	• Barden E., Thomas; Thomas, Piri; Wetherell, W. D.; Munro, Alice; Boccaccio, Giovanni; Spark, Muriel. (2010). Short Stories for Students-Presenting Analysis, Context, and Criticism on Commonly Studied Short Stories. (S. Constantakis, Ed.) Detroit, New York, San Francisco, Conn, Maine and London: Gale, Cengage Learning. • Roberts, J. L. (1980). Poe's Short Stories. Nebraska: Cliffs Notes, Inc. • Baraban, E. V. (2004). The Motive for Murder in "The Cask of Amontillado" by Edgar Allan Poe. Rocky Mountain Review of Language and Literature, 47-62. • Burns, S. (1974). "The Cask of Amontillado": Montresor's Revenge. Poe Studies (1971-1985), 25. • DiSanza, R. (2014). On Memory, Forgetting, and Complicity in "The Cask of Amontillado". The Edgar Allan Poe Review, 194-204. • Eddings, D. W. (2013). MAD About "The Raven". The Edgar Allan Poe Review, 144-162. • Esplin, E. (2013). Borges's Philosophy of Poe's Composition. Comparative Literature Studies, 458-489. • Hester, V., & Segir, E. (2014). Edgar Allan Poe: "The Black Cat," and Current Forensic Psychology. The Edgar Allan Poe Review, 175-193. • Moreland, C. T., & Rodriguez, K. (2015). "Never Bet the Devil Your Head": Fuseli's The Nightmare and Collapsing Masculinity in Poe's "The Black Cat". The Edgar Allan Poe Review, 204-220. • Hayes, T. (2020). Poe, insanity, and containing the feminine monstrous. Palgrave Communications, 6, 105. https://doi.org/10.1057/s41599-020-0415-3
Referenca të tjera	• Lima, M. A. (2010). Poe and Gothic Creativity. The Edgar Allan Poe Review, 22-30. • Bailey, J. O. (1964). What Happens in "The Fall of the House of Usher"? American Literature, 445-466.
Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat	
1	Studentet do të përvetësojnë njohuri mbi çfarë është analiza e tekstit dhe llojet e analizave.
2	Studentët do të analizojnë kontekstin, simbolet, temat kryesore etj.
3	Studentët do të aftësohen në analizimin dhe shkrimin e eseve, duke reflektuar mendimin kritik gjatë analizës së teksteve.

Mënyra e Vlerësimit të Lëndës			
Notat e Ndërmjetme	Sasia	Përqindja	
Gjysmë finale	1	20	
Kuize	0	0	
Projekte	0	0	
Projekte semestrale	1	20	
Punë laborator	0	0	
Pjesëmarrja në mësim	1	10	
Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final			50
Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final			50
Total			100
Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)			
Aktivitetet	Sasia	Kohëzgjatja (orë)	Ngarkesa Totale (orë)
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	4	64
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	4	56
Detyra	1	2	2
Gjysmë finale	1	2	2
Provimi final	1	2	2
Të tjera	0	0	0
Ngarkesa totale e orëve			126
Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)			5.04
ECTS			5.00